

1.03.2022
Ora 17:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e procedurës së hedhjes së shortit për përcaktimin e kandidatit fitues për kryetar bashkie në rastet kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja |

Parti Politike: S’ka prezent

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma kolegë! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme 1 mars. Në mbledhje janë të pranishëm pesë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e dy projektvendimeve. I pari “Për miratimin e procedurës së hedhjes së shortit për përcaktimin e kandidatit fitues për kryetar bashkie në rastet kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash”. Projektvendimi i dytë “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 18, datë 15.02.2022, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat procedurale për procesin e

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në qendrat e votimit të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Sipas rregullores së Komisionit Rregullator, më lejoni kolegë të pyes, nëse keni ndonjë çështje jashtë rendit të ditës, për të diskutuar? Nëse jo, fillojmë me rendin e ditës. Të dy projektvendimet kanë ardhur në Komisionin Rregullator për shqyrtim dhe miratim, me inisiativë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Fillojmë me projektvendimin e parë “Për miratimin e procedurës së hedhjes së shortit për përcaktimin e kandidatit fitues për kryetar bashkie në rastet kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash”. Zoti Merkaj do t’ju lutesha në mënyrë të përmbledhur të paraqesni projektvendimin dhe relacionin bashkëlidhur!

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës, ka dekretuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar përcaktimeve të nenit 20, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Neni 166, pika 2, e Kodit Zgjedhor përcakton se në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike, me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit. Referuar për sa më sipër kemi përgatitur projektvendimin, “Për miratimin e procedurës së hedhjes së shortit për përcaktimin e kandidatit fitues për kryetar bashkie në rastet kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash”. Në projektvendim kemi përcaktuar objektin e veprimeve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 1.03.2022*

paraprake ku është caktuar vendi, data dhe ora e zhvillimit të shortit publik, në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mosparaqitja e ndonjërit prej kandidatëve nuk pezullon procedurën e shortit. Shorti përsëritet për çdo zonë zgjedhore ku dy ose më shumë kandidatë kanë numër të barabartë votash. Gjithashtu kemi përcaktuar dhe procedurën e shortit, në të cilën përgatiten shirita letre ku janë vendosur emrat e kandidatëve, të cilat futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë në një enë transparente ku trazohen. Një përfaqësues i KQZ-së tërheq goglën. Emri i parë që del nga tërheqja e goglave është e kandidatit fitues të shortit të hedhur midis dy kandidatëve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Çelim diskutimin në parim për projektvendimin. Kolegë, kemi diçka lidhur me projektvendimin në parim? Në vijim të asaj që zoti Merkaj parashtroi, edhe unë do të theksoja faktin që ky projektvendim të cilin po e shqyrtojmë sot, parashikohet në nenin 166/2 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit në rastin kur dy, ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre hidhet short, gjithmonë referuar zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit. Pra, jemi në fazën që miratojmë rregullat për organizimin e shortit, nëse do të ndodhë fakti që dy, a më shumë kandidatë për kryetarë bashkie, qoftë në këto zgjedhje që janë të pjesshme, qoftë në zgjedhjet e ardhëshme të pushtetit vendor, atëherë do të mundësohet hedhja e shortit. Nëse nuk kemi diskutim tjetër në parim kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni nr. 1. Objekti. Kemi ndonjë pyetje për administratën? Ndonjë propozim për shtesa, ndryshime? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Veprime paraprake, të cilat i përkasin në fakt administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të përgatitur shortin në rast, gjithmonë nëse do të ndodhë fakti i votave të barabarta nga dy, apo më shumë kandidatë. Kemi diçka për nenin 2? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 2!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 3. Procedura e shortit për përcaktimin e kandidatit fitues për kryetar bashkie. Kolegë?! Shorti është ai që u përshkrua edhe nga Sekretari i Përgjithshëm. Në fakt ne kemi pas dhe raste të tjera që jo vetëm kemi miratuar rregulla për shortin, por edhe është hedhur shorti, veçanërisht në rastet e renditjes në fletën e votimit ku parashikohet hedhja e shortit në seancë publike. Ky është rast i një shorti tjetër. Nëse nuk kemi diçka për nenin 3 kalojmë në votimin e tij.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 4. Rezultati i shortit. Zoti Çaka, po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kryetare! Duke ju referuar Kodit Zgjedhor, por njëkohësisht edhe vendimit nr. 21 të Komisionit Rregullator të datës 18 shkurt, do të propozoja që të bënim një ndryshim në përmbajtjen e nenit 4. Duke ju referuar përmbajtjes së propozuar në projektakt, rezulton që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të bazohet në këtë rezultat të shortit për përcaktimin e kandidatit fitues. Duke qenë se bashkitë në të cilat po zhvillohen këto zgjedhje, por jo vetëm këto, edhe ato të cilat mund të jenë në të gjithë territorin e vendit, kanë karakteristika të ndryshme përsa i përket numrit të KZAZ-ve. Jo në çdo rast është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që do ta shpallë kandidatin fitues, pasi në bashkitë me një KZAZ do të jetë vetë KZAZ-ja. Propozoj që të bëhet një ndryshim sipas këtij formulimi “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim rezultatin e shortit për përcaktimin e kandidatit fitues në bashkinë përkatëse”. Pra, jo vetëm që shorti që do të hidhet nga ana e administratës do të formalizohet me një vendimmarrje të Komisionerit, por dhe kjo vendimmarrje më pas do të reflektohet në shpalljen e kandidatit fitues nga KZAZ-ja në rast se kemi bashki me një KZAZ. Nga vetë Komisioneri nëse do të jetë KQZ-ja që do të shpallë rezultatin pra, kandidatin fitues.

Znj. I. Nano: Dakord! Faleminderit zoti Çaka! Kolegë, në lidhje me propozimin e zotit Çaka, kemi diçka për të diskutuar para se të kalojmë në votim? Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Një pyetje për administratën, këtu është parashikuar që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazohet në rezultatin e shortit për përcaktimin e kandidatit fitues në bashkinë përkatëse. Si është konceptuar nga propozimi i ardhur i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e rezultatit të këtij shorti? Miratohet me vendim, apo thjesht procedura e parashikuar miratuar me këtë akt? Pra, organizohet shorti dhe shpallet? Apo ka nevojë të formalizohet me atë që propozoi kolegu Çaka, me një vendim të Komisionerit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Znj. I. Nano: Po zonja Koja!

Znj. M. Koja: Dua të shprehem dakord me propozimin e zotit Çaka për ta riformuluar.

Z. M. Çakaj: Pra, ka nevojë të shpallet me vendim të Komisionerit!

Znj. M. Koja: Po!

Z. M. Çakaj: Dakord!

Znj. I. Nano: Dakord! Atëherë, kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çaka i cili e riformulon nenin 4, "Rezultati i shortit". Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim rezultatin e shortit për përcaktimin e kandidatit fitues në bashkinë përkatëse. Është i saktë propozimi?

Z. D. Çaka: Po i saktë!

Znj. I. Nano: Dakord! Kalojmë në votimin e nenit 4 të riformuluar sipas propozimit të zotit Çaka?

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendro të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen.

Kush është dakord kolegë në tërësi me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Vendim nr. 24

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



1.03.2022
Ora 17:16

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 18, datë 15.02.2022, të Komisionit Rregullator, "Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimin elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimin (PEVN) në qendrat e votimit të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022".

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja
- Parti Politike: S'ka prezent

Znj. I. Nano: Kalojmë në projektvendimin e dytë që kemi për shqyrtim në rendin e ditës, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 18, datë 15.02.2022, të Komisionit Rregullator, "Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimin elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimin (PEVN) në qendrat e votimit të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022". Edhe ky projektvendim ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do t'i lutesha

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë të përmbledhur ku konsistojnë ndryshimet dhe shtesat e propozuara.

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr. 18, datë 15.02.2022, Komisioni Rregullator ka miratuar rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në qendrat e votimit të bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Propozohen disa ndryshime dhe një shtesë në këtë vendim duke saktësuar procedurën për dorëzimin e pajisjeve PEVN. Konkretisht në vendimin në fuqi nr. 18, përcaktohet që pajisjet PEVN dorëzohen nga ana e KQZ-së tek KZAZ nr. 26 e cila më pas bën shpërndarjen e tyre për të gjitha qendrat e votimit të Bashkisë Vorë. Projektvendimi i propozuar përcakton që dorëzimi i pajisjeve PEVN dhe i kutive shoqëruese të realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në qendrat e votimit duke e shmangur KZAZ-në. Kjo për arsye se jemi në një projekt pilot dhe jemi duke eksperimentuar se kush është mënyra më e mirë dhe më efiçente për të dorëzuar këtë pajisje për procesin e votimit, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë shqyrtimin e projektvendimit. Në parim me projektvendimin. Kolegë, kemi diçka, ju lutem? Jo! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Më lejoni të lexoj meqenëse është çështje ndryshimesh dhe shtesash.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.1.03.2022*

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit!

Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kemi shqyrtuar dhe miratuar dy projektvendime në mbledhjen e sotme, duke qenë se nuk kemi pikë tjetër në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendim nr. 25

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

